

Emër Mbiemër	BAHRI BECI
Datëlindje	02.1936
Vendlindje	Shkodër
Viti i zgjedhjes	2008
Seksioni	Shkencat shoqërore dhe albanologjike

Kontakt

Adresa:

Telefon:

Email: bahri.beci@club-internet.fr

Faqe zyrtare: www.akad.gov.al

CV e shkurtër

Gjuhëtar, profesor, akademik. Lindi në Shkodër, ku kreu dhe shkollën e mesme. Ndoqi studimet e larta dhe u diplomua në degën e gjuhës shqipe e të letërsisë në UT (1958). Prej këtij viti ka punuar në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë derisa doli në pension (1997). Në vitin 1975–1977 kreu një specializim në fushën e fonetikës eksperimentale në Institutin e Gjuhësisë dhe të Fonetikës në Paris. Drejtor i IGJL dhe kryeredaktor i revistës “Studime filologjike” (1992–1997). Në vitin 1977–2001 lektor i gjuhës shqipe në Institutin e Gjuhëve dhe të Qytetërimeve Orientale (INALCO) në Paris. Fushat kryesore të veprimtarisë së tij shkencore janë dialektologjia dhe fonetika. Ka botuar disa monografi e skica dialektore për të folmet e Luznisë, Reç-e-Dardhës, Grykës së Madhe (rrethi i Dibrës), për të folmet e krahinës së Matit dhe të Shkrelit (Malësi e Madhe). Krahas tyre ka botuar dhe artikuj që trajtojnë çështje të përgjithshme të studimeve dialektore, si klasifikimi i të folmeve të shqipes, tiparet dalluese të dy dialekteve të saj dhe lashtësia e tyre, marrëdhëniet midis dialekteve dhe gjuhës letrare. Delegat i Kongresit të Drejtshkrimit (1972).

Publikime (Monografi, Vepra kolektive, Përmbledhje studimesh)

Veprat kryesore

- *“Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës”* (1995);
- *“Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe”* (bashkautor);
- *“Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre. Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të dialektologjisë historike shqiptare”* (2002);
- *“Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri”* (Pejë 2000);

- “Probleme të lidhjes së shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit” (Pejë 2002);
- “Fonetika e gjuhës shqipe” (2004) (Tekst universitar);
- “Gramatika e gjuhës shqipe për mësuesit” (2004), 302 f. ISBN: 978-99943-64-41-1;
- “Gramatika e gjuhës shqipe” (2005), 270 f.;
- “Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe”. Vëll. I, 464 f. (2007);
- “Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe”. Vëll. II, 601 f. (2008).